

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	"Rama mori helikopterin..." / Bushati: Gjykata Speciale, iu bë dhuratë Serbisë dhe Rusisë
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/17/rama-mori-helikopterin-bushati-gjykate-speciale-iu-be-dhu-rate-serbise-dhe-rusise/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	edited

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 19:44:07 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 19:43:29 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	0bf610840f7a1daa34f2b3d5055567c3571f53b735dd1a08ead33f5e5365f12d
TEKSTI	2acdec3c860ca3271ff822b64490762e7d6eeca0c25e141a303aec18f72590b8
PAMJA	71886e2ca8edcb44a11c162906e516932282d5986241a2063a541390cf5f4de4

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	1166905c82fc363da4e753a024a76a16f5397f73a3d8c8999fe1349c45764220
E MËPARSHMJA	b2c477ad4bab142aadee08dd4c6f9e1026f03109b1d7ecd92678a714d63cb950
RRËNJA MERKLE	—
ANKORIMI	nuk është ankoruar ende <i>Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/1166905c82fc363da4e753a024a76a16f5397f73a3d8c8999fe1349c45764220>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > [AKTUALITET](#)

“Rama mori helikopterin...”/ Bushati: Gjykata Speciale, iu bë dhuratë Serbisë dhe Rusisë

21:43 : 17/09/2026 në [AKTUALITET](#), Lajmet e Dites

Analisti Andi Bushati ka komentuar në “Çim Peka Live” vendimin e Gjykatës Speciale ndaj ish-krerëve të UÇK-së, duke e cilësuar procesin si politik dhe të ndikuar nga interesa jashtë drejtësisë.

Sipas Bushatit, krijimi dhe funksionimi i kësaj gjykate duhet parë në një kontekst më të gjerë politik. Ai argumentoi se shoqëria shqiptare mund të kishte nevojë për një përballje me të kaluarën, përfshirë edhe pretendimet për krime të kryera nga shqiptarë, por sipas tij Gjykata Speciale nuk e realizoi këtë proces në mënyrën e duhur.

“Unë mendoj që këtë gjë ne duhet ta bënim. A ishte kjo gjykatë gjëja që e bëri? Këtu unë jam kundër”, tha Bushati, duke e përshkruar gjykatën si “të instrumentalizuar” dhe “politike”.

Ai u ndal më tej te mënyra se si u krijua gjykata dhe te përgjegjësia e institucioneve politike që e votuan. Bushati argumentoi se, pavarësisht formulimit të ligjit, drejtuesit politikë të Kosovës dhe aktorë të tjerë shqiptarë, sipas tij, e kishin kuptuar që procesi do të sillte pasoja për ish-komandantët e UÇK-së.

Në këtë pikë, analisti përmendi edhe qëndrimet e Hashim Thaçit në kohën kur u diskutua krijimi i gjykatës, si dhe rolin e Edi Ramës dhe aktorëve të tjerë politikë.

Lexo edhe:

TË GJITHA



Pagat e gjyqtarëve/ Pak para votimit të draftit, Rama mbërrin në Kuvend

22:04 : 17/09/2026



Shkullaku: E dinim që Gjykata Speciale do të kishte pasoja për liderët e UÇK-së, çfarë u mor në shkëmbim?

22:01 : 17/09/2026



Sikur piktori ta ndihmonte Kosovën aq sa e mbështeti Beogradin, shqiptarët do të ishin sot më të fortë

22:00 : 17/09/2026



“Nuk kam lobuar për veten”/ Berisha tregon prapaskenat e heqjes së ndalimit në SHBA

21:54 : 17/09/2026



Futbolli shqiptar në zi, ndahet nga jeta ish-lojtari i Vllaznisë

21:51 : 17/09/2026



49 ditë protestë/ Qytetarët në Divjakë vijnë kundërshtim i bashkimit me Lushnjën

21:49 : 17/09/2026



“Rama mori helikopterin...”/ Bushati: Gjykata Speciale, iu bë dhuratë Serbisë dhe Rusisë

21:43 : 17/09/2026

Shkullaku: E dinim që Gjykata Speciale do të kishte pasoja për liderët e UÇK-së, çfarë u mor në shkëmbim?

Sikur piktori ta ndihmonte Kosovën aq sa e mbështeti Beogradin, shqiptarët do të ishin sot më të fortë

Sipas interpretimit të Bushatit, krijimi i Gjykatës Speciale ishte rezultat i një kompromisi ndërkombëtar dhe ai e lidhi këtë me interesa të Serbisë dhe Rusisë. Ai argumentoi se kundërshtimi ndaj kësaj gjykate, sipas tij, duhej të ishte artikuluar që në momentin e krijimit të saj.

Bushati kritikoi gjithashtu atë që e cilësoi si “servilizëm” ndaj aktorëve ndërkombëtarë, duke kundërshtuar argumentin se qëndrimet e ambasadorëve duhet të shërbejnë si bazë për pranimin e një vendimi politik.

Në përfundim, analisti tha se mënyra se si është zhvilluar procesi në Hagë, sipas tij, ka dëmtuar mundësinë për një debat më të gjerë brenda shoqërisë shqiptare mbi pretendimet për krime të kryera gjatë dhe pas luftës në Kosovë.

Debati në studio:

Bushati: Atëherë, pavarësisht se shoqëria shqiptare kishte nevojë për këtë lloj katarsisi edhe ndaj heronjve të vet çlirimtarë. Unë kam besuar se ka njerëz që kanë thënë, jo mo nuk duhet luftë, kush ka ikur i keq i njohim e thatë, le të ikim ta mbyllim këtë kapitull. Unë mendoj që këtë gjë ne duhet ta bënim. A ishte kjo gjykatë gjëja që e bëri? Këtu unë jam kundër. Gjykatë e instrumentalizuar, gjykatë politike, gjykatë që u tregua nga mënyra si e mori Hashim Thaçin ditën që po shkonte për në Shtëpi të Bardhë e deri dje që u dha dënimi, një instrument politik. Por tani, unë besoj që këtu të biem të gjithë dakord që ky ishte instrument politik. Dhe nuk duhet të gjejmë segmente që, ja dhe ky për këtë është politik, ja çfarë tha dhe ky këtu, ja çfarë tha... Puna është të kuptojmë pse arritëm të ky instrument politik. Sepse kjo është një gjykatë që e kanë krijuar shqiptarët. Ata dje i dënuan komandantët në emër të popullit të Kosovës, e ka votuar parlamenti i Kosovës. Dhe këtu unë tund kokën ndaj Beratit. Se askush sot nuk mund të lajë duart dhe të thotë se nuk e dinim.

Buzhala: A se s'më dëgjova që përmende ligjin?

Bushati: Jo jo ligjin, ligjin, shkurt...

Buzhala: Një karrige... nuk mundesh me më thënë, nuk mundesh me i la duart kur ligji është ndryshe e akuzat ndryshe.

Bushati: Një sekondë, një sekondë. Ligji është i shkruar ashtu siç thua ti, ok, por që nga Hashim Thaçi i pari, që nga ne gazetarët, që nga Edi Rama që mori helikopterin, të gjithë e dinim që kishte arritur një pikë që duhet t'i bëhej koncesion Serbisë dhe Rusisë. Pra, vetë Hashim Thaçi në qoftë se e mbani mend, ajo beteja që ka qenë, pati tentativë në parlament për ta përmbytur gjykatën, se e dinte se çfarë e priste. Vetëvendosja, pak e parëndësishme në atë kohë, nuk është se nuk i dha argumentat. Fjalimi i Hashim Thaçit në parlament, pavarësisht se thoshte duhet ta votojmë, po ta dëgjosh të gjithë tekstin, teksti është që sa më i bën kjo gjë Kosovës. Pra të gjithë ishin të bindur, që pavarësisht si po shkruhej ligji dhe si justifikohet me Dick Martyn, këtu po i bëhej një koncesion... ne ja bënim amerikanëve dhe evropianëve, po amerikanët dhe evropianët po ja bënë Serbisë dhe Rusisë. Prandaj kësaj gjykate i duhej thënë që në gjenezë, jo. Atëherë, po po t'i thojë jo, mund të thotë dikush, bie kjo teoria jote që ka nevojë për katarsis... shoqëria duhet ta bëjë katarsisin. Unë them jo, se pikërisht ajo që ndodhi sot, dënimi i padrejtë dhe procesi surrogato ndaj atyre njerëzve, ka mbyllur njëherë e mirë kapitullin e një hapjes së debatit për krimet e shqiptarëve me shqiptarët, jo krimet me serbët, kjo mbyllet, askush nuk merr sot më guximin, thotë po krimet e shqiptarëve... shih sa u paguan ata të gjithë e të tjerë. Kjo është e keqja e parë. Dhe e keqja e dytë mendoj unë, për të cilën duhet ta vrasim mendjen shumë, është servilizmi dhe bythëlëpirja jonë ndaj ndërkombëtarëve. Berati e thotë, na thanë ambasadorët. E punë e madhe! Ambasadori mundet të bëjë trafik për t'i bërë, për të marrë një koncesion tjetër nga Rusia, Serbia, nuk është argument!

Etiketa: Andi Bushati | Edi Rama | gjykata speciale | uck

Lajme të lidhura



Shkullaku: E dinim që Gjykata Speciale do të kishte pasoja për liderët e UÇK-së, çfarë u mor në shkëmbim?

22:01 : 17/09/2026



"Populli pa bukë, Belinda me vila", pankartat e protestës së 110-të

19:46 : 17/09/2026

Sikur piktori ta ndihmonte Kosovën aq sa e mbështeti Beogradin, shqiptarët do të ishin sot më të fortë

22:00 : 17/09/2026



Aktgjykimi i Hagës përballë historisë së luftës së Kosovës

17:50 : 17/09/2026

Mbyllen fjalimet te Kryeministria, protestuesit marshojnë në rrugët e Tiranës

20:47 : 17/09/2026



Diaspora shqiptare mbledhet në "Times Square" në mbështetje të ish-krerëve të UÇK-së

17:41 : 17/09/2026

BOLD NEWS

RRETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ



2026 Boldnews Dev By Techzero1.com

Kontakt

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.